

Bazuar në nenin 35 paragrafi 1.1 i Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77 / 16 gusht 2010) dhe nenet 16, 46 dhe 85 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.11 / 11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 26 prill 2013 miratoi si në vijim:

RREGULLORE PËR MBIKËQYRJEN E KONSOLIDUAR TË GRUPEVE BANKARE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë mbikëqyrjen e konsoliduar grupeve bankare.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për të gjitha bankat e licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

Të gjithë termat e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë me termet në nenin 3 të Ligjit nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare (në vijim: *Ligjin për bankat*).

Neni 3

Mbikëqyrja e konsoliduar e grupeve bankare

Mbikëqyrja e konsoliduar është e nevojshme për të mbrojtur depozitorët dhe kreditorët e tjerë të bankave nga rreziqet që vijnë nga subjektet e lidhura me bankën. Ligji për bankat i mundëson BQK-së për të përcaktuar një “grup bankar” duke përfshirë çdo kompani që BQK-ja e konsideron të nevojshme për të siguruar që rreziqet ndaj depozituesve të një banke nuk kalojnë pa iu nënshtruar mbikëqyrjes. Ndonëse depozituesit e një banke mund të mbrohen nga përgjegjësia e kufizuar e bankës ndaj një subjekti të lidhur në praktikë, asnjë bankë nuk mund të mbijetojë dëmtimin e reputacionit të saj dhe kështu të likuiditetit dhe solventitetit të saj nga problemet e një entiteti të lidhur ngushtë me bankën

Neni 4

Qasja për mbikëqyrje të konsoliduar

1. Me qëllim të vlerësimit të fuqisë së një grupi bankar si tërësi, për BQK-në është e nevojshme të vlerësohen rreziqet në të gjitha pjesët e rëndësishme të grupit. Kjo do të bëhet si në bazë kuantitative (sasiore) ashtu edhe në bazë kualitative (cilësore). BQK-ja do të përcaktojë se cilat kompani të grupit përfshijnë rrezik të konsiderueshëm dhe t'i përfshijë ato në konsolidim. Nëse një anëtar i një grupi nuk ka rrezik të konsiderueshëm dhe lidhjet në mes të kompanive janë të dobëta, mos përfshirja e kompanive të tilla në kuadër të konsolidimit mund të jetë e pranueshme. Kompanitë jo financiare mund të përjashtohen, vetëm nëse lidhjet janë të dobëta ose rreziqet janë konsideruar si minimale. Kur lidhjet janë të ngushta BQK-ja mund të kërkojë nga banka për të riorganizuar grupin në mënyrë që pjesa financiare të jetë më e pavarur (e vetë përmbajtur).
2. Kur një grup bankar drejtohet nga një bankë mëmë, mbikëqyrja e konsoliduar është relativisht e qartë dhe normalisht do të përfshijë të gjitha filialet e bankës dhe kompanitë e lidhura. Por gjithashtu mund të jetë e dëshirueshme që të mbikëqyret një grup në një bazë të konsoliduar, ku mëma është një kompani holding ose entitet tjetër që nuk është vetë subjekt i mbikëqyrjes. Në rast të tillë një grup do të përcaktohet duke përfshirë bankën, mëmën dhe kompanitë e tjera të lidhura që sipas BQK-së paraqesin rrezik potencial ndaj depozituesve të bankës. Pra, një grup bankar normalisht do të definohet si përfshirje e të gjitha subjekteve në një kontroll të përbashkët. Kjo nuk e përjashton mundësinë e përfshirjes edhe të kompanive që nuk kanë shumicë në pronësi. BQK-ja do të përdorë teste praktike për të përcaktuar nëse një njësi ekonomike edhe nëse jo shumicë në pronësi, por megjithatë efektivisht kontrollohet nga grupi, potencialisht i ekspozon në rrezik depozituesit e bankës.
3. Kur një bankë është anëtar i një grupi që përfshin një bankë të huaj apo një kompani të huaj, BQK-ja do të konsolidojë vetëm bankën në Kosovë dhe çdo kompani të lidhur në Kosovë, pavarësisht nëse ato janë subjekte të varura të bankës në Kosovë ose subjekte të varura të degëve të huaja të grupit. BQK-ja pret nga mbikëqyrësit e vendit amë të jenë përgjegjës për mbikëqyrjen e konsoliduar të gjithë grupit siç është përcaktuar me paragrafin 1.8 të nenit 7 të ligjit për bankat. Para licencimit të një banke të tillë dhe më tej BQK-ja do të verifikojë nëse grupi vazhdon të jetë subjekt i mbikëqyrjes efektive të konsoliduar nga mbikëqyrësi i saj në vendin amë. Nëse BQK-ja nuk është i kënaqur mund të marrë hapa për të siguruar se aktiviteti i bankës në Kosovë është i izoluar nga zhvillimet gjetiu. Kjo mund të përfshijë ndryshimet në strukturën e aksionarëve të grupit.

Neni 5

Mbikëqyrja sasiore

1. Pikënisja për mbikëqyrjen kuantitative (sasiore) të një grupi bankar është përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara siç kërkohet nga standardi ndërkombëtar i kontabilitetit (SNK 27). Edhe pse BQK-ja ka të drejtë sipas nenit 53.3 të Ligjit për të përcaktuar shkallën e konsolidimit për qëllime të kontabilitetit, kjo normalisht do të mbështetet në testet në vetë SNK 27. Megjithatë, BQK-ja mund t'i përfshijë brenda fushës së saj të mbikëqyrjes së konsoliduar, njësitë ekonomike që nuk janë subjekt i kontabilitetit të konsoliduar. Pra, fakti që një njësi ekonomike nuk është konsoliduar për qëllime të kontabilitetit nuk do të thotë se nuk do të trajtohen si pjesë e grupit për qëllime të mbikëqyrjes së konsoliduar. BQK-ja mund të përjashtojë subjekte të caktuara edhe në qoftë se i konsoliduar për qëllime të kontabilitetit, nëse gjykon se rreziqet nuk janë materiale apo të rëndësishme. Për qëllime të caktuara

kuantitative (sasiore) BQK-ja mund të përjashtojë kompanitë e sigurimeve për shkak të vështirësisë për të kombinuar pasuritë dhe detyrimet e kompanive të sigurimit me ato të subjekteve të tjera financiare. Kjo mund të zbatohet për llogaritjet e mjaftueshmërisë së kapitalit, por jo për llogaritjet e ekspozimeve të mëdha.

2. Nga grupet bankare gjithashtu do të kërkohet të përgatitin dhe të paraqesin në BQK bilancin e gjendjes dhe raporte tjera statistikore në bazë të konsoliduar. Këto do të mundësojnë llogaritjen e raporteve të mjaftueshmërisë së kapitalit për grupin në tërësi në mënyrë që të sigurohet që nuk bëhet numërimi i dyfishtë i kapitalit. Kërkesat dhe detyrimet brenda grupit në këtë proces do të eliminohen. Në rast të subjekteve të varura të kompanive të sigurimeve atëherë investimi në kompaninë e sigurimeve do të zbritet nga kapitali i kompanisë mëmë me qëllim të përcaktimit të kapitalit të grupit. Për aplikimin e detajuar të kërkesave të mjaftueshmërisë së kapitalit në një grup bankar, bankat duhet të veprojnë në përputhje me Rregulloren e BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.
3. Raportet kuantitative (sasiore) gjithashtu do të mundësojnë llogaritjen e ekspozimeve të mëdha dhe pozicionet valutore për grupin në tërësi. Ekspozimet e bankës ndaj rreziqeve tjera të tregut, p.sh. rreziku i normës së interesit dhe rreziku i investimeve në letra me vlerë do të vlerësohet në bazë të grupit. Rregullorja e BQK-së për Ekspozimet e Mëdha përcakton sesi limitet e ekspozimeve të mëdha do të aplikohen për grupet për të cilat BQK-ja ka përcaktuar aplikimin e mbikëqyrjes së konsoliduar.
4. Kufizimet për ekspozimet në valutë të huaj, të parashikuara nga neni 50 i Ligjit për bankat dhe e rregulluar me Rregulloren e BQK-së për Rrezikun nga Aktiviteti me Valuta të Huaj do të jenë të zbatueshme për grupin si tërësi, si dhe mbi bazë individuale.

Neni 6 **Mbikëqyrja cilësore**

1. Përveç mbikëqyrjes kuantitative (sasiore), BQK-ja do të marrë në konsideratë edhe aspektet kualitative (cilësore). Ky proces do të përfshijë përcaktimin e lidhjeve në mes anëtarëve të ndryshëm të një grupi bankar dhe kuptimin dhe vlerësimin e lidhjeve të menaxhmentit, si dhe lidhjet krejtësisht financiare. Për shembull, BQK-ja mund të kërkojë që një subjekt i varur i bankës së një grupi të ketë drejtorë të pavarur në numër të mjaftueshëm në Bordin e saj për të vepruar në mënyrë të pavarur nga kompanitë e tjera të grupit dhe në këtë mënyrë të sigurojë që i kushtohet vëmendje e mjaftueshme përgjegjësisë së bankës ndaj depozituesve të saj. Informata e mbledhur në këtë proces do të ndikojë në vendimet e BQK-së se cilët anëtarë të një grupi duhet të përfshihen në grupin e konsoliduar për qëllime të mbikëqyrjes. Kur një grup përbëhet nga një përzierje e subjekteve financiare dhe subjekteve tjera, BQK-ja mund të kërkojë të përfshihen aktivitetet financiare dhe të përjashtohen subjektet me aktivitet jo financiar për qëllim të mbikëqyrjes së konsoliduar. Megjithatë, për të bërë këtë BQK-ja dëshiron të sigurojë që asnjë lidhje financiare dhe lidhje menaxheriale të mos jetë e tillë që të dëmtoj procesin. Kështu që një nën-grup financiar pritet të ketë drejtorë dhe menaxherë të pavarur, në mënyrë që mos të ndikohet jashtë mase nga menaxhmenti i entiteteve që janë jashtë nën-grupit financiar të konsoliduar. Kjo mund të kërkojë disa ndryshime në mënyrën e strukturimit të një grupi nëse vlerësohet që struktura pengon mbikëqyrjen efektive të konsoliduar.

2. BQK-ja do të përdorë gjithashtu edhe kompetencat në bazë të nenit 81 të Ligjit për bankat, kur dyshon se një subjekti i pa licencuar brenda një grupi kryen aktivitete të ndaluara me Ligjin për bankat ose në bazë të ligjeve tjera relevante.
3. BQK-ja kërkon që një firmë të jetë përgjegjëse për auditimin e jashtëm të të gjitha kompanive të një grupi dhe jo të mbështetet në punën e disa kompanive audituese.

Neni 7 Informatat

1. Baza e mbikëqyrjes së konsoliduar është mbledhja e informatave nga ana e BQK-së. Neni 57 i ligjit i jep kompetenca BQK-së, për të marrë informacion jo vetëm nga subjektet e mbikëqyrura brenda një grupi bankar, por edhe nga subjektet tjera të lidhura me subjektin e mbikëqyrur për të përcaktuar shkallën e lidhjes së përshkruar më lart. Në disa raste gjithashtu mund të jetë e nevojshme për BQK-në që të ekzaminojë edhe subjekte jo financiare siç parashihet në nenin 57 të Ligjit për bankat. Mirëpo me këtë nuk nënkuptojmë se subjektet e tilla mbikëqyren nga BQK-ja, sidomos kur këto subjekte janë të një karakteri jo financiar. Normalisht, BQK-ja do të mbështetet në anëtarët bankarë të një grupi për informacione në lidhje me grupin si tërësi dhe në lidhje me subjektet jo- të mbikëqyrura brenda grupit, por mban të drejtën për të verifikuar çfarëdo që është e nevojshme edhe nëpërmjet ekzaminimit në vend.
2. Kur një grup bankar përfshin subjektet e mbikëqyrura apo të rregulluara nga një autoritet tjetër mbikëqyrës në Kosovë apo jashtë vendit, BQK-ja do të mbajë diskutime periodike me autoritetet mbikëqyrëse të tilla, që janë të nevojshme për të kuptuar marrëdhëniet në mes të kompanive kosovare dhe të huaja në grup dhe të jetë në gjendje për të parë sesa i shëndoshë është grupi dhe komponentët e tij. Neni 79 i Ligjit fuqizon (i jep të drejtë) BQK-në për të shkëmbyer informacione në lidhje me një bankë të Kosovës me këto autoritete të tjera rregullatore me kusht që informacioni do të përdoret për qëllime të mbikëqyrjes dhe do të nënshtrohen në të njëjtën shkallë të konfidencialitetit, si në Kosovë, siç kërkohet sipas nenit 80 të Ligjit. Në raste të tilla BQK-ja normalisht do të kërkojë një Memorandum të Mirëkuptimit ose marrëveshje tjetër të ngjashme me autoritetet e huaja mbikëqyrëse.

Neni 8 Procedura për mbikëqyrje të konsoliduar

Nëse BQK-ja vlerëson se ekziston një grup bankar që kërkon mbikëqyrjen e konsoliduar, ajo do të diskutojë me anëtarin kryesor të grupit bankar mbi natyrën këtyre lidhjeve. Nëse, në bazë të diskutimeve të tilla ajo konstaton se grupi kërkon mbikëqyrje të konsoliduar, BQK-ja do të informojë bankën me shkrim, duke radhitur subjektet të cilat propozohen për t'u përfshirë nën mbikëqyrjen e konsoliduar. Konstatimi do të tregojë gjithashtu nëse është nevoja për ndonjë përshtatje konsolidimi për qëllime të kontabilitetit. Letra do të radhit raportet që do të kërkohen nga grupi, nëpërmjet bankës kryesore, në mënyrë që të sigurohen në bazë të konsoliduar, si dhe në bazë individuale nga ana e anëtarit të grupit bankar. Gjithashtu, BQK-ja do të njoftojë bankën sesi pritet grupi të respektojë kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe kërkesat e ekspozimeve të mëdha në bazë të konsoliduar, si dhe në bazë individuale për bankën.

Neni 9
Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

1. Masat në lidhje me shkeljen e kësaj rregulloreje ose urdhrave të dhëna në bazë të saj normalisht do të merren ndaj anëtarit kryesor të grupit. BQK-ja, në rrethana të caktuara do të marrë masa të drejtpërdrejta edhe kundër subjekteve tjera brenda grupit, nëse rrethanat e kërkojnë. Aty ku BQK-ja nuk ka kompetenca të mjaftueshme për të korrigjuar mangësitë, BQK-ja mund të urdhërojë bankën të ndërpresë lidhjet e saj me subjektet e tjera brenda grupit.
2. Shkelja e kësaj rregulloreje do të jetë objekt i masave mbikëqyrëse dhe ndëshkimore të parashikuara në nenet 58, 59, 82, të Ligjit për bankat

Neni 10
Dispozita kalimtare

Subjektet e kësaj rregulloreje, jo më vonë se tre (3) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, duhet të rishikojnë dhe/ose aprovojnë politikatat dhe procedurat e brendshme në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

Neni 11
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja për mbikëqyrjen e konsoliduar të grupeve bankare e lëshuar nga Bordi i BQK-së me 03 dhjetor 2012.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me datën 10 maj 2013, në ditën e publikimit në ueb faqen e BQK-së.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Sejdi Rexhepi